

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT

GJYKATA (SEKSIONI I DYTË)

RASTI ARCURI DHE TRE TË TJERË KUNDËR ITALISË

(Aplikacioni nr. 52024 /99)

VENDIM

STRASBURG

5 korrik 2001

FAKTET

Aplikuesit Rocco Arcuri, Anna Maria Mussurici, Mirko Arcuri dhe Greta Guarino janë nënshtetas italianë, që kanë lindur në 1933, 1951, 1974 dhe 1970. Ata jetojnë në Turin. Aplikuesi i tretë është djali i dy aplikuesve të parë, që janë çift i martuar. Aplikuesi i katërt është vajza e aplikuesit të dytë. Aplikuesit janë prezantuar para Gjykatës nga z. Barone, avokat i cili e ushtron profesionin në Milano.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç dorëzohen nga aplikuesit, mund të përmbliidhen si vijon.

Përderisa aplikuesi i parë dyshohej se është anëtar i organizatës kriminale të involvuar në trafikim të narkotikëve zyra e Prokurorisë së Turinit ka nisur procedurën kundër tij me 23 tetor 1995 për aplikim të masave preventive të disponueshme sipas Aktit nr.1423 të 27 dhjetorit 1956 dhe Aktit nr.575 të 31 majit 1965, të amendamentuar me Aktin nr.646 të 13 shtatorit 1982. Zyra e Prokurorisë ka kërkuar sekuestrimin e një numri asetesh që i përkisnin aplikuesit të parë dhe/ose aplikuesve tjerë.

Në një urdhër të datës 31 tetor 1995 Presidenti i Divizionit të Gjykatës së Qarkut në Turin i specializuar në masa preventive ka dhënë urdhërin për sekuestrim të asetëve në fjalë ku përfshiheshin tetë vetura, disa parcela toke dhe apartamente, aksionet e dy kompanive private dhe dokumente të shumta. Ai ka theksuar se inspektimet e kryera nga brigada anti mafia (DIA) ka treguar mospërputhje ndërmjet mjeteve financiare të aplikuesit dhe aktiviteteve të tij ligjore afariste dhe të ardhurave të deklaruara.

Gjatë procedurave paraprake janë marrë në pyetje dy aplikuesit dhe dëshmitarë të shumta, Raportet e kontabilistëve dhe ekspertëve të financave janë përpiluar dhe transkriptet e bisedave të regjistruara telefonike janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës. Gjykata poashtu ka urdhëruar prodhimin e dokumenteve specifike në lidhje me procedurat tjera gjyqësore që janë zhvilluar kundër aplikuesit të parë dhe/ose personave tjerë të dyshuar se i përkasin organizatave të llojit mafioz. Të gjithë aplikuesit, të përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga ata, kanë marrë pjesë në procedurat për aplikim të masave preventive.

Në një urdhër të 13 qershorit 1997 që ishte dorëzuar në Sekretari me 24 korrik 1997 divizioni i Gjykatës së Turinit, të specializuar për masat preventive ka vendosur ta vë aplikuesin e parë nën mbikëqyrje të policisë, kombinuar me një urdhër për qëndrim të detyrueshëm në qarkun e Turinit për katër vite. Divizioni special gjithashtu ka urdhëruar konfiskimin, sipas nenit 2 (3), paragrafi i tretë, i Aktit nr. 575 të 1965, të asetëve të aplikuesit të sekuestruara paraprakisht.

Gjyqtarët e divizionit special kanë theksuar së pari se ndërmjet 1959 dhe 1980 aplikuesi i parë ka qenë dënuar për një numër mashtrimesh, nxitje për prostitucion, sulm, detyrim, burgim falso, paturpësi vulgare në vend public, përdorim i çeqeve të pavlera, posedim i paligjshëm i armëve të zjarrit, bankrotim mashtrues dhe shoqërim me kriminelë. Gjithashtu, nga një numër dokumentesh të gjetura në shtëpinë e aplikuesit të parë rezultoi se ai ishte në kontakt të afërt me persona që ishin pjesë e krimit të organizuar. Më tej, procedurat për fajde dhe shoqërim me persona mafioz po zhvilloheshin kundër aplikuesit të parë. Pa dyshim, në procedurat penale për shoqërim me kriminelë paraburgimi është revokuar, megjithatë ai fakt nuk i ka parandaluar gjyqtarët të marrin në konsideratë se është "e mundshme" që ai person është i involvuar në

organizatën kriminale, se ka huazuar para me përqindje tejet të larta të interesit dhe se ai ka kërcënuar me jetë ata që nuk kanë paguar me kohë borxhin. Mbajtja e vazhdueshme e një të akuzuari është arsyetuar kur ka pasur “ probabilitet të madh” se ata janë fajtorë, përderisa aplikimi i masave preventive do të mund të bazohej në një shkallë më të ulët të probabilitetit.

Për sa i përket situatës financiare të familjes Arcuri, divizioni special i gjykatës ka observuar se ishte shumë vështirë të rindërtohet historia e aktiviteteve të ndryshme ekonomike tëndërmarra nga aplikuesi i parë sepse ai nuk ka mbajtur të dhëna zyrtarë për aktivitetet e tij. Në çfarëdo rasti , ishte e qartë prej dëshmisë të prodhuara se së paku një pjesë e pasurisë së madhe të aplikuesit të parë ishte fituar në mënyrë të paligjshme, pasi që ishin të ardhura prej veprave të tij penale të bankrotimit falso, përdorimit të çeqeve të pavlera, tregtisë së paligjshme me diamantë dhe fajdeve. Për më tepër aplikuesit nuk kanë ofruar dëshmi sipas të cilës do të tregonin se ato të ardhura ishin fituar në mënyrë të ligjshme. Pa dyshim, një pjesë e aseteve zyrtarisht i përkisnin aplikuesve të dytë, tretë dhe të katërt, megjithatë divizioni special ka gjetur se tërë pasuria e familjes është krijuar nga aplikuesi i parë i cili pasi ishte nënshtruar procedurave të shumta gjyqësore, e ka parë të rrugës të transferojë disa asete në emër të dy fëmijëve dhe për ta bërë gruan partnere nëaktivitetet e tij afariste.

Aplikuesit ka apeluar kundër urdhërit të 13 qershorit 1997.

Në një urdhër të 2 shkurtit 1998 Gjykata e Apelit e Turinit ka mbështetur vendimin e gjykatës së qarkut. Ka observuar, inter alia se divizioni special i gjykatës ka gjetur se aplikuesi i parë ishte i rrezikshëm për shoqërinë në bazë të deklaratave të bëra në procedurat tjera gjyqësore nga *pentiti* përkatës të Mafias, që kanë bashkëpunuar përmes dëshmisë substanciale dhe kanë treguar se aplikuesi i parë është endur në qarqet kriminale së paku deri në fillim të 1990. Transkripti i bisedave të regjistruara telefonike ka treguar se aplikuesi i parë i ka kërcënuar borxhlinjtë ashpër. Për sa i përket deklaratës së tij se mjetet e tij financiare do të mund të shpjegoheshi ekskluzivisht përmes aktiviteteve të tij ligjore si biznesmen, Gjykata e Apelit konsideron se pasuria e familjes Acuri është krijuar prej të ardhurave të aktiviteteve kriminale. Më tej, mungesa e dokumentacionit të saktë ka bërë të pamundur vlerësimin e profitit real të cilin e ka arritur aplikuesi i parë prej transaksioneve përkatëse të biznesit. Gjithashtu kishte dëshmi që tregonin se aktivitetet ligjore të familjes Acuri kanë filluar, janë zhvilluar dhe mirëmbajtur me të ardhurat e veprave penale të kryera nga aplikuesi i parë.

Gjykata e Apelit, së fundi ka vërejtur se, sipas ligjit zakonor të Gjykatës së Kasacionit, asetet të cilat ishin subjekt i masës preventive në lidhje me pronën nuk duhet ti përkasin formalisht personit i cili duket se është rrezik për shoqërinë, pasi që i fundit thjeshtëmund ti përdorë ato de facto sikurse të ishte pronar. Aplikuesi i parë nuk ka menduar se transferi i aseteve specifike tek aplikuesi i tretë dhe i katërt e ka bërë të pamundur që ai ti përdorë ato si ka dëshiruar. Për sa i përket aplikuesit tëdytë , edhe nëse do të ishte e vërtetë se ai ka qenë i përfshirë në një numër të aktiviteteve afariste, aplikuesi i parë ka mbajtur pak a shumë rolin fillestar në menaxhimin dhe organizimin e atyre aktiviteteve.

Aplikuesit kanë paraqitur një ankesë nëbazë të ligjit. Në opinionin e 3 korrikut 1998 që u dorëzua në Sekretariat me 12 shtator 1998 Gjykata e Kasacionit e ka shkarkuar apelin e aplikuesve, duke mbështetur Gjykatën e Apelit në Turin që ka dhënë arsye logjike dhe të përshtatshme për të gjitha pikat e konfliktit ndërmjet palëve.

B. Ligji vendor relevant

Në përputhje me seksionin 2 (3) të Aktit nr. 575 të 31 majit 1965, gjatë procedurave për aplikim të masave preventive kundër personit të dyshuar për anëtarësim në organizatë të tipit mafioz, “Gjykata e Qarkut mund të lëshojnë një vendim te arsyeshëm, qoftë edhe të mocionit të vet, që do të urdhëronte sekuestrimin e pronës në disponueshmëri direkte ose indirekte të personit kundër të cilit janë inicuar procedurat, kur ka dëshmi të pamjaftueshme rrethanore, sikurse mospërputhja e madhe ndërmjet stilit të tij të jetesës dhe të hyrave të tij të dukshme, për të treguar se prona në fjalë krijon të ardhura prej aktiviteteve të paligjshme ose riinvestime. Së bashku me implementimin e masave preventive Gjykata e Qarkut do të urdhërojë konfiskimin e çfarëdo malli të sekuestruar që nuk dëshmohet të jetë fituar ligjshëm. Gjykata e Qarkut do ta revokojë urdhërin për konfiskim kur shkarkohet aplikimi i masave preventive ose kur tregohet se prona në pyetje ishte fituar në mënyrë të paligjshme.

ANKESAT

1. Aplikuesit kanë deklaruar se masa preventive e konfiskimit ka shkelur të drejtën e tyre për të gëzuar pronën, siç garantohet në Nenin 1 të Protokollit nr.1.
2. Mbështetja në nenin 6 §§1 dhe 3 të Konventës, aplikuesit janë ankuar në padrejtësitë për aplikim të masave preventive.

LIGJI

1. Aplikuesit kanë deklaruar se masa preventive e konfiskimit ka shkelur të drejtën e tyre për të gëzuar pronat, sic garantoht në Nenin 1 të Protokollit nr.1. Ai Nen thotë:

“ cdo person ligjor ose fizik ka të drejtën të gëzojë pronën e tij. Asnjë nuk duhet të deprivohet prej pronës së vet përveç kur një gjë e tillë është në interes dhe subjekt i kushteve të siguruar me ligj dhe përmes parimeve të përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Dispozitat pasuese, në asnjë mënyrë, nuk do të shkelin të drejtën e Shtetit për të zbatuar ligjet e tilla pasi është e domosdoshme të kontrollohet përdorimi i pronës në pajtim me interesat e përgjithshme ose të sigurojë pagesën e taksave ose kontributet a gjobat tjera”.

Gjykata thekson se konfiskimi pa dyshim përbënte ndërhyrje në të drejtat e aplikuesve për gëzim të pronës të tyre (shih M V. Italisë, aplikacioni nr, 12386/86, Vendimi i Komisionit i 15 Prillit 1991, Vendimet dhe Raportet (DR) 70, f. 59, në f 99).

Gjykata theksoi se asetet e prekura nga konfiskimi, që konsiderohen nga Gjykata se janë fituar në mënyrë të paligjshme dhe synn të parandalojë aplikuesin e parë, i cili, sipas gjykatave Italiane, do të mund të përdorte asetet direkt ose indirect për të krijuar profit për veten ose për organizatën kriminale të cilës dyshohet se i përkiste, në dëm të komunitetit.

Kështu, edhe pse masa në fjalë ka dërguar deri tek deprivimi i pronës, ajo ka arritur kontrollin e përdorimit të pronës brenda kontekstit të paragrafit të dytë të Nenit 1 të Protokollit nr.1 që i jep shtetit të drejtën të adaptojë “ ligjet e tilla nëse është nevoja të kontrollojë përdorimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm” (shih Agosi kundër Opinioni të Mbretërisë së bashkuar, i datës 24 tetor 1986, seria A nr. 108, f. 17 S 51 et seq dhe Handyside kundër opinionit të Mbretërisë së Bashkuar, datës 7 dhjetor 1976, Seritë A nr. 24, pp. 29 dhe 30 S S 62-63).

Për sa i përket përputhshmërisë me kushtet e atij paragrafi, Gjykata thekson se konfiskimi i aseteve të aplikuesit është urdhëruar sipas seksionit 2 (3) të Aktit 1965. Pra ishte ndërhyrje e udhëzuar me ligj.

Gjykata thekson më tej se konfiskimi ka synuar parandalimin e përdorimit të paligjshëm , në një mënyrë të rrezikshëm për shoqërinë, të aseteve origjina e paligjshme e të cilave nuk është vërtetuar. Për këtë konsideron se qëllimi i ndërhyrjes i shërben interesit të përgjithshëm (shih Raimondo kundër Italisë, opinion i datës 22 shkurt 1994, Seritë A nr 281-A , f.17 S 30 dhe Vendimi i Komisionit në M kundër Italisë të cituar më lartë, f 59, në p 100). Pa marrë parasysh, mbetet të përcaktohet nëse kjo ndërhyrje ishte proporcionale me qëllimin e përgjithshëm.

Në këtë aspekt, Gjykata thekson se masa e ndërmarrë formon një pjesë të politikës për parandalim të krimit, konsideron se në implementimin e një politike të tillë legjislatura duhet të ketë një marzhë më të gjerë të mirëkuptimit për sa i përket ekzistencës së problemit i cili prekë interesin e publikut që kërkon masa të kontrollit dhe mënyrën e përshtatshme për të aplikuar masa të tilla.

Më tej Gjykata observon se në Itali problemi i krimit të organizuar ka arritur një nivel shumë brengosës.

Profitet e mëdha të krijuara nga këto organizata prej aktiviteteve të tyre të paligjshme i japin atyre një nivel të autoritetit që e vë në rrezik sundimin e Ligjit brenda shtetit. Mjetet e përdorura për të luftuar këtë autoritet ekonomik, sidomos masën e konfiskimit në të cilën janë ankuar, mund të duken thelbësore për ndjekje penale të suksesshme të organizatës kriminale (shih opinionin Raimondo të cituar më lartë, f.17 S 30 dhe vendimin e Komisionit në M kundër Italisë të cituar më lartë, f101)

Gjykata nuk mund të nënvlerësojë rrethanat specifike në të cilat janë ndërmarrë veprimet nga legjislatura Italiane. Megjithatë, ka një detyrë për të kënaqur vehten se të drejtat e garantuara nga Konventa respektohen në cdo rast.

Gjykata thekson se në këtë rast seksioni 2 (3) I Aktit 1965 përcakton se kurëdo që ka “ dëshmi të pamjaftueshme të rrethanave” prezumimi se prona e personit të dyshuar për anëtarim në organizatë kriminale përfaqësin të ardhura prej aktiviteteve të paligjshme ose është fituar me ato të ardhura.

Cdo sistem ligjor e njeh prezumimin e faktit ose të ligjit. Konventa me siguri se nuk i ndalon prezumimet e tilla në parim. Megjithatë, e drejta e aplikuesve për të gëzuar pronën e vet implikon ekzistencën e një garancioni efektiv gjyqësor. Më pas, Gjykata duhet të shqyrtojë, duke konsideruar ashpërsinë e masave preventive, nëse procedurat në gjykatat Italiane i kanë dhënë aplikuesve mundësinë e paraqitjes së rastit të tyre tek autoritetet përgjegjëse (shih, mutatis mutandis, opinionin Agosi cituar më lartë, f.18S 55).

Në këtë aspekt, Gjykata thekson se procedurat për aplikim të masave preventive janë zhvilluar në prezencë të të dyja palëve në tri gjykata – Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Kasacionit. Në vecanti, aplikuesit, duke udhëzuar avokatin e zgjedhur vet, ishin në gjendje të bënin vërejtje dhe të sjellin dëshmi për të cilat ata mendonin se ishin të domosdoshme për të mbrojtur interesat e veta që tregojnë se të drejtat e mbrojtjes janë respektuar.

Poashtu, Gjykata vëren se Gjykatat Italiane nuk kanë mundur ti bazojnë vendimet e tyre në dyshime të thjeshta. Ato është dashur të vendosin dhe të vlerësojnë objektivist faktet e dorëzuara nga palët dhe nuk ka asgjë në dosje që sugjeron se ata kanë vlerësuar dëshminë e paraqitur tek ata në mënyrë arbitrare.

Në të kundërtën, gjykatat Italiane kanë bazuar vendimet e tyre në dëshmi të zhvilluara kundër aplikuesit të parë që tregojnë se ai ishte në kontakt të rregullt me anëtarët e organizatave kriminale dhe se kishe mospërputhje të mëdha ndërmjet burimeve të tyre financiare dhe të ardhurave të tij. Poashtu gjykatat vendore kanë analizuar me kujdes situatën financiare të aplikuesve tjerë dhe natyrën e relatave të tyre me aplikuesin e parë dhe kanë konkluduar se të gjitha asetet e konfiskuara kanë mundur të blihen vetëm përmes riinvestimit të z. Rocco Accuri me profitet e paligjshme dhe de facto janë menxhuar nga ai, duke i atribuar titullin ligjor tre aplikuesve të fundit në mënyrë që ti shmangej mundësisë së konfiskimit të aseteve në fjalë (shih , mutatis mutandis , Autorino kundër Italisë, aplikacioni nr. 39704/98, Vendimi i Komisionit i datës 21 maj 1998, i paraportuar) .

Më tej, qëllimi preventiv i konfiskimit e ka arsyetuar aplikimin e tij imediat pavarësisht nga ndonjë apel (shih opinionin Raimondo të cituar më lartë, f. 17 S 30)

Duke qenë kështu, duke pasur parasysh marzhen e mirëkuptimit të Shteteve kur ato “ kontrollojnë përdorimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm” , sidomos në kontekst të politikës së kimit të dizajnuar për të luftuar krimin serioz, Gjykata konkludon se ndërhyrja në të drejtat e aplikuesit për të gëzuar pronën nuk ishte disproporcionale me qëllimin legjitim (shih opinionin Raimondo të cituar më lartë , p.17 S 30 dhe Vendimin e Komisionit në M kundër Italisë të cituar më lartë, f.120)

1. Rezulton se kjo ankesë duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar, në pajtim me Nenin 35 SS 3 dhe 4 të Konventës.
2. Aplikuesit janë ankuar për padrejtësinë e procedurave për aplikim të masave preventive. Ato janë mbështetur në Nenin 6 SS 1 dhe 3 të Konventës, pjesët relevante të së cilës:
“1. Ne përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të veta civile ose të cfarëdo aktakuze kundër tij , cdokush ka të drejtë për dëgjim ... ose tribunal...të drejtë...”
3. Cdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtat minimale si vijon:
 - (a) Të informohet drejtë, në gjuhën të cilën e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;
 - (b) Të ketë kohë dhe mjete adekuate për përgatitjen e mbrojtjes së tij;
 - (c) Të mbrojë veten personalisht ose përmes asistencës ligjore të zgjedhjes së tij ose nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar asistencën ligjore ti ofrohet e njejtja pa pagesë në rast se ashtu kërkojnë interesat e drejtësisë;

(d) Të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij nën të njëjtat kushte sikurse dëshmitarët kundër tij”.

Gjykata, së pari, duhet të përcaktojë nëse dispozita në të cilën mbështetet është e aplikueshme në rastin në fjalë.

Gjykata përsëritë se , sipas çështjes së ligjit të institucioneve Kushtetuese, masat preventive të udhëzuara nga Aktet Italiane të 1956, 1965 dhe 1982 , që nuk involvojnë të gjeturat e fajësisë, por janë dizajnuar për të parandaluar gëzimin e fitimit nga vepra penale, nuk janë të krahasueshme me ‘ sanksionet’ kriminale (shih opinionin Raimondo të cituar më lartë, p.20 S 43; Ciulla kundër Italisë 22 shkuer 1989, Seritë A no.148, p.17 S 39, Guzzardi kundër Italisë opinionin i 6 nëntorit 1980, Seritë A nr39 p.37 S 100 dhe Vendimi i Komisionit në M kundër Italisë i cituar më lartë në pp 94-98).

Pra, procedurat nën ato dispozita nuk kanë involvuar “ përcaktimin e aktakuzës” (shih opinion Raimondo të cituar më lartë, p.20 S 43 dhe opinionin Guzzardi të cituar më lartë p.40 S 108) Paragrafi i tretë i Neni 6 që ka të bëjë me të drejtat e personave të akuzuar për vepër penale nuk aplikohet në këtë rast.

Duhet të përcaktohet tutje nëse procedurat e paraqitura kundër aplikuesit kishin të bëjnë me “ të drejta civile dhe obligime” brenda kuptimit të paragrafit të Neni 6.

Gjykata thekson në këtë aspekt, se neni 6 aplikohet në çfarëdo veprimi ku çështja subjektive është “monetare”përnga natyra dhe është ndërtuar në një shkëlqje të supozuar të të drejtave me natyrë “monetare” (shih Raimondo opinionin e cituar më lartë , p,20 S 43 dhe Edicionet Periscope kundër Francës të 26 marsit 1992, Seritë A nr. 234-B, p.66 S 40) .

Duke qenë kështu, Neni 6 S 1 , nën kontekstin civil, është i aplikueshëm në procedurat në fjalë.

Aplikuesit kanë supozuar se vendimet e gjykatave vendore janë bazuar në shtrebbërim të fakteve dhe nëgabime të ligjit , se ta janë parandaluar prej së dëshmuari se prona e tyre është blerë në mënyrë të ligjshme dhe se në cdo rast autoritetet kanë kthyer mbrapa barrën e provës duke prezumuar se prona në pyetje është fituar në mënyrë të paligjshme. Ky prezumim, sipas tyre, është bazuar në dyshime të thjeshta e jo në dëshmi të sjella gjatë procedurave.

Gjykata përsëritë se nuk është detyrë e saj të merr rolin e gjykatave vendore.Është primare për autoritetet nacionale, sidomos për gjykata, të zgjedhë problemet e interpretimit të legjislacionit vendor dhe të vlerësojë faktet (shih ndër shumë autoritete tjera Brualla Gomez de la Torre kundër Spanjës 19 dhjetor 1997 , Raportet mbi gjykimet dhe vendimet 1997-VIII, p 2955 S 31 , dhe Edicionet March Gallego S,A kundër Spanjës 19 shkurt 1998 p.290 S 33) Nuk është detyrë e Gjykatës të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave vendore ose të marrin vendim nëse elementet përkatëse janëpranuar si duhet si dëshmi mirëpo në vend të kësaj duhet të shqyrtojnë nëse procedurat e zhvilluara si tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën është pranuar dëshmia, kanë qenë të drejta (shih,

ndër autoritetet tjera , Doorson kundër Holandës 26 mars 1996, Raportet 1996-II, p.470 S 67 dhe Va Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës , 23 prill 1997 , raportet 1997-III, p.711 S 50).

Sic ka theksuar më lartë Gjykata, në Nenin 1 të Protokolit nr. 1, procedura për aplikimin e masave preventive janë zhvilluar në prezencë të të dyja palëve dhe me respekt për të drejta të mbrojtjes para tri gjykatave tjera. Ato gjykata nuk mund ti bazojnë konkludimet e tyre në dyshime të thjeshta dhe japin arsyet e tyre në të gjitha pikat e çështjes që do të thotë se është mangur çfarëdo rreziku i arbitrit.

Në vijim, kjo ankesë duhet të refuzohet si e pabazuar, në pajtim me Nenin 35 SS 3 dhe 4 të kësaj Konvente.

PËR KËTO ARSYE , GJYKATA UNANIMISHT

Deklaron se aplikacioni është i papranueshëm.

Erik Fribergh

Christos Rozakis

Sekretar

President